



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË MJEDISIT

Nr. 5111 Prot.

Tiranë, më 28.05.2019

Nr. Identifikimi 505

Vendimi 29

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “ANA - 2013” sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L37009201B

Adresa e selisë: Rruga “Nacionale Vlorë-Lepenicë” km 30, Lagjja “Lepenicë”, Zona kadastrale 79/5, Godinë 1-katësh nr.1, Vlorë

Personi përgjegjës: Pandeli Veshaj

Për të zhvilluar projektin: “**Shfrytëzim i mineralit gëlqeror dekorativ me punime sipërfaqësore (me karrierë)**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: objekti “Lepenicë”, zona minerare 70/9, Nj.A. Brataj, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë

Të dhëna teknike:

Sipërfaqja e zgjeruar: 0.268 km²

Lloji Mineralit: gur gëlqeror dekorativ

Shfrytëzimi: Sipërfaqësor

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoria e Teknikës të Ministrisë shprehen: Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë, shprehet: Parimisht dakort për zhvillimin e aktivitetit

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në shkresën zyrtare kthim përgjigje me nr. 503/1 prot. datë 30/04/2019 drejtuar subjektit shprehet si më poshtë vijon: Referuar shkresës suaj, datë 18.04.2019, “Kërkesë për verifikimin dhe dhenie mendimi për zhvillim aktiviteti”, lidhur me veprimtarinë e “Nxjerrjes së gureve gëlqerore dekorative me punime sipërfaqësore”, në objektin minerar “Lepenicë”, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, ju sqarojmë se: Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, si dhe referuar koordinatave për zgjerimin e sipërfaqes për cilën ju kërkon mendim,

X 4463725	Y 4384018
X 44633655	Y 4384248
X 4463430	Y 4384330
X 4463526	Y 4383607
X 4463637	Y 4383611
X 4463400	Y 4383610

rezulton se pika më e afërt për ndërhyrje të gurëve gëlqerorë dekorativë është 260 metra larg (MN) “Shpella e Shkruar e Lepenicës”. Nga verifikimet e kryera në terren nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Vlorë, rezulton se aktiviteti i punimeve do të zhvillohet në drejtim të kundërt me monumentin e natyrës, arsye kjo për të qënë sa më larg tij.

Meqënëse ky aktivitet do të zhvillohet jashtë sipërfaqes së monumentit të zonës buferike, shprehemi pozitivisht për zhvillimin e tij, por kërkojmë të zbatoni me korrëktesi kushtet dhe kriteret e lejës mjedisore dhe të respektoni me përpikmeri kryerjen e punimeve, vetëm në sipërfaqen sipas koordinatave të mësipërme.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Akt-Miratimin Nr. 1792 nga MEI, me nr. prot 1382/2 datë: 10.03.2016 objektin “Lepenicë”, Qarku Vlorë
- Njoftimin për fillim procedure nga MIE për zgjerimin e lejës nr. 1792, datë 10.01.2019
- Akt Miratimin Leje Mjedisit Tipi B me Nr. 4422 Prot. datë: 08.07.2016, Nr.ID. 2044, K.Nr.04

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.3 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.
- 4.4 **Bazuar në shkresën kthim përgjigje me nr. 503/1 prot. datë 30.04.2019 të AKZM, aktiviteti të zhvillohet brenda koordinatave të miratuara nga ky institucion dhe në drejtim të kundërt me monumentin natyror “Shpella e Shkruar e Lepenicës”**

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.5 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.6 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.7 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.8 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.9 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.10 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.

- 4.11 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.12 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.13 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.14 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.15 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.16 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.17 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.18 Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.19 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.20 Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.21 **Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Nr. 60/2014 datë 19.6.2014, “Për një ndryshim në ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca I, duhet t’i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.**

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI



MINISTRI

BLENDI KLOSI

Aneksi 1. Harta me koordinatat

KOMUNA E MIRE

